

VENDIM
Nr. 224, datë 9.11.2021

**MBI NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 216, DATË 11.10.2018,
MBI TRANSFERIMIN E LICENCËS PËR OPERIMIN E SISTEMIT TË SHPËRNDARJES
SË ENERGJISË ELEKTRIKE, TË SHOQËRISË OPERATORI I SHPËRNDARJES SË
ENERGJISË ELEKTRIKE SHA (OSHEE SHA), ME NR. 250, SERIA P14SH, MIRATUAR ME
VENDIMIN E BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-s NR. 96, DATË 27.10.2014, TE
SHOQËRIA “OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES” SHA (OSSH SHA), E
VLEFSHME DERI MË DATË 27.10.2044**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë; nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 9.11.2021, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 139/4 prot., datë 2.11.2021, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 216, datë 11.10.2018, mbi transferimin e licencës për operimin e sistemit të shpërndarjes së energjisë elektrike, të Shoqërisë Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a. (OSHEE sh.a.), me nr. 250, seria P14SH, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 96, datë 27.10.2014, te shoqëria “Operatori i Sistemit të Shpërndarjes” sh.a. (OSSH sh.a.), e vlefshme deri më datë 27.10.2044”,

konstatoi se:

- Me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 216, datë 11.10.2018, shoqërisë “Operatori i Sistemit të Shpërndarjes” sh.a. i është transferuar licenca e Operimit të Sistemit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, të shoqërisë “Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike” sh.a. (OSHEE sh.a.), me nr. 250, seria P14SH, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 96, datë 27.10.2014, e vlefshme deri më datë 27.10.2044.

- Kushti i pikës 2, i vendimit të Bordit të ERE-s me nr. 216/2018, kërkon që: “2. Shoqëria “Operatori i Sistemit të Shpërndarjes” sh.a. (OSSH sh.a.), të paraqesë në ERE listën e personelit, sipas profilit, në përputhje me aktivitetin për të cilin kërkohet licenca, pasi të përfundojë transferimi i personelit për këtë shoqëri “Operatori i Sistemit të Shpërndarjes” sh.a. (OSSH sh.a.), nga struktura përkatëse.”.

- Kushti i sipërcituar është miratuar në zbatim të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e cila konkretisht, në nenin 9, pika 2, germa “e”, kërkohet: “Struktura e ndërtimit dhe e funksionimit administrativ të shoqërisë, sipas pozicioneve dhe profileve përkatëse ...”

- Në kuptim të sa më sipër, shoqëria “Operatori i Sistemit të Shpërndarjes” sh.a. me shkresën nr. 8754/2 prot., datë 20.10.2021, protokolluar në ERE me nr. 973/1 prot., datë 22.10.2021, ka bërë me dije se me vendimin e Këshillit të Administrimit nr. 9, datë 31.12.2019, është miratuar në parim organigrama e shoqërisë OSSH sh.a. dhe me vendimin e Këshillit të Administrimit të saj nr. 20/1, datë 9.12.2020, është miratuar struktura organizative e shoqërisë OSSHE sh.a., sipas organigramës që ka përcjellë bashkëlidhur edhe në ERE me një numër prej 5837 punonjësish.

- Me plotësimin e kushtit nga shoqëria, kjo e fundit rezulton me një dokumentacion të plotësuar tërësisht.

- Në nenin 113, të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, është parashikuar mundësia e shfuqizimit të plotë apo të pjesshëm të një akti, me nismën e vetë organit, që e ka nxjerrë, duke përcaktuar dhe formën ligjore të ndryshimit të aktit, e cila duhet të bëhet me një akt të ri me shkrim.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të shfuqizojë pikën 2 të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 216, datë 11.10.2018.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë subjektin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE, brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti